



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRAN
AGJENCIA E SHËRBIMEVE FUNERALE
NJËSIA E PROKURIMIT

Data: 29/ 04/ 2025

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - Mallra

Objekti i Procedurës: “Blerje rroba pune”.

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (FPP): Veshje, këpucë, artikuj valixhe dhe aksesore-18000000-9. Dorashka pune-18141000-9. Kaskë sigurie - 18142000-6. Pelerina-18211000-1. Jelekë- 18235400-9. Kostume- 18222100-2.

VLERA E FONDIT LIMIT: 1,323,256.42 (një milion e treqind e njëzet e tre mijë e dyqind e pesëdhjetë e gjashtë pikë dyzet e dy) lekë pa TVSH, vënë në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë Tiranë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në nenin 76, pika 2, gërma ”b” të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar. Njësia e prokurimit për përllogaritjen e vlerës limit të objektit të kësaj procedure prokurimi iu referua studimit të tregut për marrjen e ofertave nga subjekte të ndryshme që operojnë në treg. U përdor kjo alternativë me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut, duke marrë parasysh edhe ndryshimet e çmimeve dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

Njësia e Prokurimit për procedurën në fjalë vendos që lloji i procedurës së prokurimit të jetë:
Procedurë e Hapur e thjeshtuar, mallra.

Arsyet e përdorimit të procedurës - “ E hapur e thjeshtuar”, Mallra, është sepse vlera e fondit limit është nën kufirin e ulët monetar.

Kriteret e përgjithshme të pranimit janë standarte dhe nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 2 pika “c”, nenit 78 pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit

Adresa: Rruga e “Durrësit”, Nr.132, Tiranë, Shqipëri

publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor, Agjencia e Shërbimeve Funerale, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënues për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënues ose nuk ka qenë i dënues nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kriterë duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 9.**

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimi nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Argumentimi: Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Agjencia e Sherbimeve Funerale ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 26 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimi/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit sipas shtojcës 9 në DST, dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 26 pika 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **në një vlerë jo më të vogël se 40% e fondit limit të përlllogaritur**. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 43 pika 2 dhe neni 55 pika 4 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2, të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “*Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata*”. Vendosija e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për të zbatuar me sukses kontratën siç është parashikuar nga AK.

Për sa i takon përcaktimit të vlerës së kërkuar **në një vlerë jo më të vogël se 40% e fondit limit të përlllogaritur**, është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2 dhe neni 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se “*Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar*”.

b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: (2022, 2023, 2024) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga*

auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit”, **Nëse kërkohen bilance të tre viteve të fundit, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit** si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.”, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar. Si dhe bazuar në Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c. Me anë të këtij kriteri, për paraqitjen e bilanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.2.3 Vetëdeklarim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025, sipas Ligjit 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomik duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2025, të parashikuara në ligjin 9632, datë 30.10.2006 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 3 e LPP, i ndryshuar, si dhe nenit 43 pika 6, nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, dhe në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar në ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar, neni 40, në ligjin nr.131/2015 “Për QKB”, i ndryshuar.

Për të vërtetuar që subjekti nuk është debitor në pagimin e taksave vendore të Qeverisjes Vendore dhe është subjekt që garanton qëndrueshmëri dhe është korrekt me detyrimet ligjore që ai ka. Është kërkuar vetëm viti 2025 për të siguruar konkurrencë të lirë për gjithë OE fizike apo juridike.

Ky kriter shërben për të garantuar AK se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, kanë kapacitetet e duhura ekonomike dhe financiare si dhe janë të përshtatshëm për të kryer veprimtari profesionale. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2025, pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari Biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, **në një vlerë jo më të vogël se 20% e fondit limit.**

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- Operatorët ekonomikë si dëshmi për përvojën e mëparshme duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

- Në rastin e përvojes së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, neni 40 pika 4, neni 55 pika 4/b. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin certifikatë të vlefshme të cilësisë, ku të përfshijë objektin që prokurohet, të cilat duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara, sipas standardeve:

- **Çertifikatë ISO 9001:2015 ose ekuivalente/të barazvlefshme – Standart për “Sistemin e menaxhimit të cilësisë”.**

Çertifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, pika 1 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 40 pika 8 dhe nenit 44, pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë.

3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë pranë Autoritetit kontraktor nga një mostër fizike për artikujt me nr. rendor: (2,3,4,5,8,10), sipas tabelës të përcaktuar në shtojcën 7 të DST.

-Mostrat do të paraqiten në datën dhe orën e hapjes së ofertave, pranë “Agjencisë së Shërbimeve Funerale”, me adresë: Rr. “Durrësit” nr.132, përballë me Ministrinë e Arsimit, Tiranë.

- Mostrat të jenë të shoqëruara me një shkresë, me listë inventarizimi dhe të identifikuara sipas numrit rendor të përcaktuar në shtojcën 7 të DST, e firmosur dhe vulosur nga ofertuesi. Mostrat duhet të kenë të ngjitur nga një etiketë e cila të përmbajë: “Emërtimin i mallit”, numrin rendor të përcaktuar në shtojcën 7 të DST, emrin e ofertuesit, datën dhe orën e zhvillimit të tenderit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik. Mostrat duhet të kenë të qepur etiketën origjinale të fabrikës ku janë prodhuar dhe të jenë me ambalazhim fabrike.

- Përfaqësuesi i operatorit ekonomik ofertues, në rastet kur nuk paraqitet përfaqësuesi ligjor, duhet të pajiset me autorizimin përkatës nga ofertuesi për paraqitjen e mostrave në emër dhe për llogari të tij.

Mosparaqitja e mostrave sipas kushteve të caktuara më sipër është kusht për skualifikim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin të 36, dhe 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 40, pika 6/a dhe 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Udhezimit me nr. 03, datë 12.04.2022 „Mbi procesin e administrimit të mostrave të paraqitura nga operatorët ekonomikë“.

Paraqitja e mostrave të kërkuara lidhet drejtpërdrejtë me verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të produkteve të ofruara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me ato të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit ”.....mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar

dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit....” Mostrat e kërkuara janë vetëm për disa artikuj që kanë peshë kryesore për procedurën dhe janë më të kërkuarat. Kjo kërkesë vjen edhe për arsye se punonjësit që do ti përdorin rrobat e punës punojnë në terren në kushte atmosferike te ndryshueshme dhe prandaj kërkohet një cilësi e lartë e këtyre mallrave.

Qëllimi i vendosur nga ligjvënësi për paraqitjen e mostrave, është dhënia e mundësisë autoritetit kontraktor, i cili është përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, të kryerjes së verifikimeve (ekzaminim, inspektim, testim) të mostrave të dorëzuara nga operatori ekonomik në rast se këto të fundit janë në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor të pasqyruar në specifikimet teknike të procedurës së prokurimit.

4. Operatori ekonomik në lidhje me artikujt objekt prokurimi të përcaktuar në Shtojcën 7 “Formulari i sasisë dhe Grafiku i ekzekutimi”, që do të paraqesë, duhet të plotësojë tabelën e mëposhtme duke specifikuar vendin e origjinës si dhe çertifikimet të lëshuara nga një organ i akredituar/autorizuar.

Nr.	Emërtimi i produktit	Vendi i origjinës	Prodhuar/Distributor	Certifikatë konformiteti ose cilësie CE (kur është e aplikueshme)/ekuivalent
1				
2				
Etj.,				

Shënim:

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin në SPE certifikatat e çdo produkti në momentin e dorëzimit të ofertave.

Të dhënat që do të deklarohen, detyrimisht do ti paraqiten Autoritetit Kontraktor për të qenë pjesë e planit të zbatimit të kontratës. Rastet e deklaratave të rreme, do të konsiderohen kushte për skualifikim, si dhe do të ndiqet procedura për përjashtim nga Agjencia e Prokurimit Publik.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 1/a, dhe 4 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenet 40 pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të plotësojnë kërkesat e standarteve në lidhje me garantimin e cilësisë së mallit/

Adresa: Rruga e “Durrësit”, Nr.132, Tiranë, Shqipëri

produktit objekt prokurimi në mënyrë të qëndrueshme, ku referuar natyrës së mallrave/artikujve që kërkohet të kryhet furnizimi i tyre, njësia e prokurimit ka kërkuar certifikatën e mësipërme për vërtetimin se operatorët ekonomikë i plotësojnë kërkesat e cilësisë për këto mallra (ka të bëjë me parimet e produkteve, duke filluar nga faza e projektimit, prodhimit dhe shitjes së produktit/artikullit) duke i dhënë besimin e plotësimit të kërkesave të cilësisë për mallrat/ produktet blerësit (Autoritetit Kontraktor). Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës.

5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Certifikatën OEKO-TEX standard 100 të tekstileve (ose ekuivalente) të prodhuesit të lëndës së parë të artikujve objekt prokurimi, për të vërtetuar se lënda e parë e artikujve të ofruara nuk kane substanca të dëmshme për shëndetin dhe janë në përputhje me normativat e specifikuar të certifikimit OEKO-TEX standard 100 të tekstileve ose ekuivalente. Në mungesë të certifikimit OEKO-TEX standard 100 të tekstileve ose ekuivalente, do të pranohen raportet e testimit të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, të cilat vërtetojnë se lëndët e para nuk kanë substanca të dëmshme për shëndetin e njeriut dhe janë në përputhje me normativat e specifikuar të certifikimit OEKO-TEX.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 1/a, dhe 4, nenin 79 pika 1, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenet 40 pika 6/ c dhe 44 pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të plotësojnë kërkesat e standarteve në lidhje me garantimin e cilësisë së mallit/ produktit objekt prokurimi në mënyrë të qëndrueshme, ku referuar natyrës së mallrave/artikujve që kërkohet të kryhet furnizimi i tyre, njësia e prokurimit ka kërkuar certifikatën e mësipërme për vërtetimin se operatorët ekonomikë i plotësojnë kërkesat e cilësisë për këto mallra (ka të bëjë me parimet e produkteve, duke filluar nga faza e projektimit, prodhimit dhe shitjes së produktit/artikullit) duke i dhënë besimin e plotësimit të kërkesave të cilësisë për mallrat/ produktet blerësit (Autoritetit Kontraktor).

Gjithashtu, bazuar në specifikat dhe natyrën e mallrave/ artikujve objekt kontrate që kërkohen të furnizohen, duke qënë se ato duhet të jenë të prodhuar nga lëndë të parë të cilat nuk përmbajnë substanca të dëmshme për shëndetin e njeriut dhe të jenë në përputhje me standartet CE/ ose ekuivalent dhe direktivave, vlerëson se operatorët ekonomik duhet të paraqesin dokumentacionin e kërkuar, që vërteton lidhjen me prodhuesin ose distributorin e autorizuar nga do t'i sigurojnë këto mallra objekt kontrate, Certifikatën OEKO-TEX për tekstilet (ose ekuivalente me to), ose në mungesë të saj dëshmitë e testeve zyrtare të kryera, me qëllim verifikimin/ vlerësimin nga A.K., nëse këto mallra/ artikujt për të cilat do të ofertojnë operatorët ekonomik pjesëmarrës janë në përputhje me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara në dokumentat e tenderit, si dhe janë të prodhuara nga prodhues të certifikuar për prodhimin e tyre me cilësi dhe brenda standarteve të miratuara.

Këto kritere për kapacitetet profesionale e teknike janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Por edhe sepse mbi të gjitha ato i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e aftësisë profesionale, organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë për mallrat objekt prokurimi katalog dhe / ose skedë teknike sipas standarteve në specifikimet teknike nga firma prodhuese, në mënyrë që të verifikohet pajtueshmëria e specifikimeve teknike të mallrave të ofertuara me specifikimet teknike të kërkuara nga Autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar nën të 36, dhe 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/b dhe 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij të bazuar në legjislacionin e prokurimit publik dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij si më sipër cituar, për të kërkuar kataloget teknik të mallrave objekt prokurimi, për verifikimin e përputhshmërisë së tyre me specifikimet teknike, të cilat edhe këto nga ana tjetër duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor.

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të krahasuar pajtueshmërinë e specifikimeve teknike dhe standartet e kërkuara nga AK.

7. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Raport Testimi (fletë-analizë) për artikullin: “*Kostume pune për burra (xhakete+pantallona)*”, “*Përparëse pune për gra*” dhe “*Pelerinë shiu*”, të lëshuar nga laboratorë të akredituar, sipas legjislacionit në fuqi, që vërtetojnë përputhshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. (Copa e përdorur për artikullin mostër, lëndës së parë që shoqëron atë dhe ajo që i bashkëngjitet fletë -analizës duhet të jenë detyrueshme të njëjta).

➤ OE duhet të paraqesë në SPE Çertifikatat e konformitetit për artikullin **Çizme për burra/gra** sipas standartit :SSH/EN ISO 20347:2012, ose ekuivalente.

➤ OE duhet të paraqesë në SPE Çertifikatat e konformitetit për artikullin **Kepuce mbrojtëse me qafa:** SSH/ EN ISO 20345 S3, ose ekuivalente.

➤ OE duhet të paraqesë në SPE Çertifikatat e konformitetit për artikullin: **Kostum pune për burra(Pantallona+xhakete):** SSH /EN ISO 20471 klasi 2 ose ekuivalente.

➤ OE duhet të paraqesë në SPE Çertifikatat e konformitetit për artikullin **Jelek fosfori:** SSH/ EN ISO 20471 ose ekuivalente.

➤ OE duhet të paraqesë në SPE Çertifikatat e konformitetit për artikullin **Pelerinë Shiu:** SSH/ EN ISO 343:2019 CLASS 3.1 ose ekuivalente.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar nën të 36, dhe 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/c dhe 8, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi, i shërben autoritetit kontraktor për të provuar nëse operatori ekonomik ka kapacitetet për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të

verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi nëpërmjet testimit dhe metodave të testimit. Testimi është kërkuar vetëm për tre artikuj që konsiderohen të rëndësishme për autoritetin kontraktor, kurse për artikujt e tjerë janë kërkuar certifikatat perkatese ose ekuivalente. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë.

8. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë një numër minimal prej 1 (një) punonjës të punësuar, i cili duhet të rezultojë në listëpagesa për periudhën të paktën muajin e fundit nga data e hapjes së ofertave.

Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të punonjësve në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 9 në DST, *dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, duhet të paraqesë:

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për muajin Mars 2025.
- Listëpagesa e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme, si dhe

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenin 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë kapacitete teknike dhe profesionale për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

9. Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi, huapërdorje ose me qira, automjet me qëllim transportin e mallrave objekt prokurimi. Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të automjetit në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 9 në DST, *dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, duhet të paraqesë:

Dokument që vërteton pronësinë ose huapërdorjen ose qiramarrjen si më poshtë:

- a) Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); leje qarkullimi; çertifikatë për transport mallrash (e vlefshme), çertifikatë e kontrollit teknik, (i vlefshëm); siguracion mjeti, (i vlefshëm).
- b) Për mjetet e deklaruara me qera/huapërdorje duhet të paraqitet: kontrata përkatëse noteriale e qerasë/huapërdorjes e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë),

Adresa: Rruga e “Durrësit”, Nr.132, Tiranë, Shqipëri

leje qarkullimi; certifikatë e kontrollit teknik, (i vlefshëm); certifikatë për transport mallrash, (i vlefshëm), siguracion mjeti (i vlefshëm);

c) Foto e dukshme të mjetit bashkë me targën.

Për sa më sipër operatori ekonomik të paraqes një deklaratë përkatëse sipas formatit të mëposhtëm:

Nr.	Lloji i mjetit	Targa	Kapaciteti mbajtes	Statusi
1				Pronësi/qira/përdorim

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenin 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Vendosja e kriterit, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për t’u garantuar se mjeti do të jetë i pajisur me të gjithë dokumentacionin e rregullt tekniko-ligjor, i gatshëm për qarkullim rrugor.

10. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin deklaratë që furnizimi do të bëhet me mjetet dhe shpenzimet e operatorit ekonomik fitues sipas grafikut të lëvrimit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që marrin përsipër realizimin e objektit të kontratës, nëpërmjet transportit me mjetet dhe shpenzimet e tyre, sipas grafikut të lëvrimit të vendosur nga autoriteti kontraktor.

11. Operatori ekonomik pjesëmarrës **duhet të deklarojë dhe të marr përsipër marrjen e masave trupore** të të gjithë punonjësve të Agjencisë së Shërbimeve Funerale (Sektorëve Sharrë, Tufinë dhe Njësitë Administrative).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që marrin përsipër realizimin e objektit të kontratës, nëpërmjet marrjes së masave para dorezimit të mallit.

12. Ofertuesi duhet të paraqesë deklaratë mbi garancinë e mallrave që kërkohen të prokurohen për një periudhë, jo më pak se **12 (dymbëdhjetë) muaj** nga dita e marrjes në dorëzim nga AK të artikujve objekt prokurimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që marrin përsipër realizimin e objektit të kontratës, nëpërmjet garancise së mallrave objekt prokurimi. Kjo deklaratë shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor.

Shënim: Në zbatim të nenit 26 pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Shënim: Në mbështetje të nenit 88 pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, nëse kemi bashkim operatorësh ekonomikë, secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

II. SASIA E MALLIT QË KËRKOHET DHE GRAFIKU I LËVRIMIT

Grafiku i lëvrimit hartuar njësia e prokurimit është si më poshtë vijon:

Sasia e mallit që kërkohet:

Artikulli	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Destinacioni	Periudha e dorëzimit
1	Doreza me veshje gome	pale	162	Magazina e institucionit	30 dite
2	Bluza pune pambuku me tre kopsa vere per gra	cope	51	Magazina e institucionit	30 dite
3	Bluza pune pambuku me tre kopsa vere per burra	cope	55	Magazina e institucionit	30 dite
4	Kostume pune per burra	cope	56	Magazina e institucionit	30 dite
5	Jelek fosfori	cope	89	Magazina e institucionit	30 dite
6	Çizme per burra	pale	56	Magazina e institucionit	30 dite
7	Çizme per gra	pale	56	Magazina e institucionit	30 dite
8	Perparse pune per gra	cope	58	Magazina e institucionit	30 dite
9	Kepuce mbrojtese me qafa	pale	157	Magazina e institucionit	30 dite
10	Pelerine shiu	cope	158	Magazina e institucionit	30 dite

Grafiku i lëvrimit të mallit:

Afatet e lëvrimit: Afati i lëvrimit është 30 ditë kalendarike duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës. Operatori ekonomik fitues do të kryejë furnizimin e mallit sipas grafikut të lëvrimit në magazinë.

III. SPECIFIKIMET TEKNIKE PER OBJEKTIN: “BLERJE RROBA PUNE”

1. Doreza pune me veshje gome. Doreza pune pambuku të veshura me gomë duke kaluar kycin e dorës, cilësore, që përdoruren në ndërtim dhe kopshtari. Goma të ketë dendësi të lartë, duke bërë të mundur një mbrojtje maksimale nga mjetet e forta. Veshja e gomës të jetë elastike dhe e rehatshme gjatë përdorimit. Ngjyra e dorezave të jetë e errët.

2. Bluze pune pambuku me tre kopsa (gra) (logo). Materiali të jetë 100% pambuk, Pesha: 180-200 gr/m², me tre kopsa me jakë dhe mëngë të shkurtra. Logo do të jetë sipas modelit bashkëlidhur. Ngjyra gri e çelur.

3. Bluze pune pambuku me tre kopsa (burra) (logo). Materiali të jetë 100% pambuk, Pesha: 180-200 gr/m², me tre kopsa me jakë dhe mëngë të shkurtra. Logo do të jetë sipas modelit bashkëlidhur. Ngjyra gri e çelur.

4. Kostume pune për burra (pantallona+XHAKETA) (logo).

a) Xhaketa

Materiali të jetë 65% polyester dhe 35% pambuk, pesha 240-280 gr/m², cilësi e lartë. Xhaketa ka dy xhepa të pjerrët me fileto në pjesën e poshtme dhe dy xhepa pllakë në pjesën sipër. Mbyllja e xhaketes do të jetë me zinxhir i cili mbulohet nga një copë mostër dhe me percina. Xhaketa do të jetë me mëngë të gjata, të cilat të jenë të pajisura me manshetë të mëngët dhe në pjesën fundore. Xhaketa në gjithë perimetrin e gjoksit dhe mbrapa duhet të jetë e pajisur në një fileto kordon të hollë fosforeshente me gjerësi 0.5-1 cm. Gjatësia e xhaketes do të jetë sipas standarteve të xhaketave të kostumeve klasike dhe jo më e shkurtër. Qëndrueshmëria e ngjyrës në larje 40°C. Logo do të jetë sipas modelit bashkëlidhur. Ngjyra e negociueshme midis blu e errët dhe gri e errët.

b) Pantallonat

Materiali të jetë 65% polyester dhe 35% pambuk 240-280 gr/m², cilësi e lartë. Në pjesën e përparme do të kenë dy xhepa të pjerrët. Qëndrueshmëria e ngjyrës në larje 40°C. Ngjyra e negociueshme midis blu e errët dhe gri e errët.

5. Jelek fosfori (logo). Jeleku është i përbërë nga material 100% poliester. Me shirit 5cm fosforeshent në pjesën e përparme dhe në pjesën e pasme, për të bërë të mundur parandalimin e aksidenteve. Jeleku të ketë të stampuara logon të dukshme. Logo do të jetë sipas modelit bashkëlidhur.

6. Çizme per burra. Çizmet me material 100% PVC me qafë të gjata deri afër gjurit, të jenë të padepërtueshme nga uji dhe shollë me lule. Ti rezistojnë ndryshimeve të temperaturës në ambjentin e punës. Cilësi e lartë.

7. Çizme per gra. Çizmet me material 100% PVC me qafë të gjata deri afër gjurit, të jenë të padepërtueshme nga uji dhe shollë me lule. Ti rezistojnë ndryshimeve të temperaturës në ambjentin e punës. Cilesi e lartë.


8. Përparse pune për gra (logo). Materiali të jetë 65% poliestër dhe 35% pambuk. Pesha: 240-280 gr/m². Të ketë jakë, hapja para dhe mbërthimi me kopsa. Në pjesën e përparme të saj të ketë dy xhepa dopi pllakë dhe sipër një xhep në krahun e majtë. Përparset të jenë me mëngë të gjata dhe me gjatësi të trupit deri afër gjurit. Logo do të jetë sipas modelit bashkëlidhur. Qëndrueshmëria e ngjyrës në larje 40°C. Ngjyra e negociueshme midis blus së errët dhe jeshiles.

9. Këpucë mbrojtese me qafa. Këpucë mbrojtëse me qafë të gjatë, që përdoren në ndërtim. Këpucët të jenë material lëkure, të janë të pajisura me shtresë metalike në pjesën e poshtme dhe pjesën e përparme, gjë që i siguron këmbës një mbrojtje maksimale kundër dëmtimeve gjatë punës me gozhdë, vida, dhe peshave të ndryshme që mund të bien mbi këmbë. Veshja e tyre e bredshme të jetë me sfungjer.

10. Pelerine shiu profesionale (logo). Materiali të jetë 62% poliestër dhe 38% polyamide. Pesha: 180-200 gr/m². Tekstil i gomuar, mospërshkrueshmëria nga uji 100%. Siperfaqja e trajtuar me solucione kundra rrezeve UV, e bën më rezistente kete veshje edhe nga rrezet e diellit. Pelerina do të jetë e gjatë deri poshtë gjurit me mëngë të gjata dhe me kapuç. Mbyllja të jetë me zinxhir nga brenda dhe percina nga jashtë dhe me dy xhepa në pjesën e përparme në secilën anë. Qëndrueshmëria e ngjyrës në larje 30°C. Logo do të jetë sipas modelit bashkëlidhur.

Bashkëlidhur DTS është edhe logo për veshjet për të cilat është kërkuar vendosja e logos.

Për sa i përket masave të rrobave të punës, operatori ekonomik fitues do të bëjë matjen e punonjësve në bashkëpunim me Autoritetin kontraktor në fillim të zbatimit të kontratës.



Logo: Stema e Bashkisë Tiranë dhe në anë mbishkrimi “BASHKIA TIRANË” dhe poshtë tij mbishkrimi “SHËRBIMI FUNERAL”, sipas modelit të mësipërm për veshjet, për të cilat është kërkuar vendosja e logos. Meqënëse ngjyrat e veshjeve për të cilat është kërkuar logo janë të errëta, ngjyra e shkrimit do të jetë e bardhë, ndërsa stema e bashkisë me ngjyra.

Argumentimi i specifikimeve teknike: Specifikimet teknike, grafiku i lëvrimit për mallin objekt prokurimi, janë hartuar nga specialisti i fushës, të cilat janë bashkëlidhur me dokumentet e tenderit. Ato përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, i ndryshuar me Ligjit nr. 16/2024, datë 8.2.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose

origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP, i ndryshuar me Ligjit nr. 16/2024, datë 8.2.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

NJESIA E PROKURIMIT